



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 449 Prot.

Tiranë, më 02.07 2015

VENDIM Nr. 68 datë 23.06.2015

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 41 dhe 43, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.9, të datës 23.06.2015, pasi shqyrtoi *Projektin kërkimor shkencor në vazhdim "Antigonea"* miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Qendra e Studimeve Albanologjike), paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë, drejtues Prof. Dhimitër Çondi (IA),

VENDOSI:

- I. Të miratojë *Projektin kërkimor shkencor në vazhdim "Antigonea"* paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë, drejtues Prof. Dhimitër Çondi (IA), në lidhje me veprimtarinë e mëposhtme:
 - Vazhdimi i gërmimeve në sektorin G dhe G1.
 - Kryerja e disa sondazheve me qëllim evidentimin e teatrit, në anën jugore të qytetit, jashtë murit rrethues.
- II. Periudha kohore e kryerjes së punimeve brenda gjashtëmuajorit të dytë të vitit 2015.
- III. Në rastet kur parashikohet ndërhyrje në sit/nëntokë dhe evidentohen struktura, duhet të përcaktohen masat që do të merren për konservimin/restaurimin/translokimin e tyre. Gjithashtu, në çdo rast, duhen përcaktuar masat për rehabilitimin e zonës.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI

MINISTËR



SEKRETAR I KKA

RUDINA ZOTO



Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: sekretaria.kka@asha.gov.al

Website: www.asha.gov.al